DOKUMENTI KONSULTATIV

PROJEKTLIGJ "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10352, DATË 18.11.2010, "PËR ARTIN DHE KULTURËN", I NDRYSHUAR

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, 'Për artin dhe kulturën', i ndryshuar" synon përditësimin e kuadrit ligjor që rregullon fushën e artit dhe kulturës, në përputhje me zhvillimet dhe nevojat aktuale të sektorit. Ndryshimet propozojnë qartësimin e objektit, fushës së zbatimit dhe përkufizimeve ligjore, njohjen e artistëve dhe profesionistëve të kulturës, si dhe përfshirjen e formave bashkëkohore, digjitale dhe multidisiplinare të krijimtarisë artistike. Projektligji parashikon gjithashtu zgjerimin e listës së institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, qartësimin e funksioneve dhe parimeve të veprimtarisë së tyre, përmirësimin e mekanizmave të drejtimit dhe funksionimit, përfshirë përbërjen dhe emërimin e bordeve artistike. Një ndërhyrje e rëndësishme lidhet me zgjerimin e burimeve të financimit dhe rregullimin e administrimit të të ardhurave të institucioneve, duke parashikuar që 90 për qind e të ardhurave nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, shitja e biletave dhe shërbimet përkatëse të përdoren në favor të institucionit që i realizon, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit. Gjithashtu, përcaktohen destinacionet e përdorimit të këtyre të ardhurave, mekanizmat e raportimit dhe monitorimit financiar, si dhe rregullat për përcaktimin e tarifave dhe lehtësitë për kategori të caktuara përfituesish. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet përmirësimi i funksionimit institucional, mbështetja e krijimtarisë dhe zhvillimit profesional, forcimi i qëndrueshmërisë financiare të institucioneve dhe zgjerimi i aksesit të publikut në art dhe kulturë.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 13 nëntor 2026 deri në datë 12 dhjetor 2026.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrit elektronik në adresën http://www.konsultimipublik.gov.al.

Kontakti:

Irena Prici *Irena.Prici@mtks.gov.al* Eliverta Vraniçi *Eliverta.Vranici@mtks.gov.al*

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin "Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike" 20 ditë pune, duke filluar nga data 13 Nëntor 2026.

Sfondi i propozimit legjislativ

Propozimi legjislativ buron nga nevoja për rishikimin dhe përditësimin e ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar, me qëllim përshtatjen e kuadrit ligjor me zhvillimet bashkëkohore të sektorit të artit dhe kulturës, si dhe me nevojat që kanë evidentuar praktikat e zbatimit të tij ndër vite.

Zhvillimi i formave të reja të krijimtarisë dhe shprehjes artistike, zgjerimi i veprimtarisë kulturore në hapësirën digjitale dhe ndërdisiplinore, si dhe diversifikimi i aktorëve që kontribuojnë në këtë sektor kanë krijuar nevojën për një përcaktim më të qartë të fushës së zbatimit të ligjit, terminologjisë dhe koncepteve themelore. Në këtë kuadër, vlerësohet e nevojshme njohja dhe përfshirja më e qartë e artistëve, profesionistëve të kulturës, subjekteve private dhe aktorëve të skenës së pavarur kulturore, si pjesë përbërëse të ekosistemit të artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë.

Një tjetër arsye që dikton ndërhyrjen legjislative lidhet me nevojën për të qartësuar dhe përshtatur kuadrin e organizimit dhe funksionimit të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke marrë në konsideratë misionin, natyrën dhe specifikat e veprimtarisë së tyre. Në këtë drejtim, projektligji synon zgjerimin e kategorisë së institucioneve të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit, nëpërmjet përfshirjes së Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, duke respektuar njëkohësisht dispozitat e legjislacionit të posaçëm që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre.

Gjithashtu, praktika e funksionimit të institucioneve publike ka evidentuar nevojën për një përcaktim më të qartë të qëllimit, funksioneve dhe përgjegjësive të tyre, si dhe për forcimin e autonomisë profesionale dhe artistike, lirisë së shprehjes dhe krijimtarisë, pluralizmit dhe diversitetit kulturor. Në këtë kuadër, propozohet përmirësimi i rregullave për drejtimin dhe funksionimin e institucioneve, përfshirë rolin e organeve kolegjiale, mënyrën e emërimit dhe kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të bordeve artistike, si dhe procedurat për miratimin e rregulloreve të brendshme.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që justifikon ndërhyrjen ligjore lidhet me nevojën për përmirësimin e mekanizmave të financimit dhe administrimit financiar të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës. Kuadri aktual kërkon plotësim në drejtim të identifikimit dhe qartësimit të burimeve të financimit, administrimit të të ardhurave të gjeneruara nga veprimtaria institucionale dhe përcaktimit të destinacionit të përdorimit të tyre. Për këtë arsye, projektligji parashikon një mekanizëm të posaçëm sipas të cilit, nga të ardhurat e realizuara prej administrimit dhe shfrytëzimit të pasurive dhe aseteve, shitjes së biletave, si dhe ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në ligj, 90 për qind përdoren në favor të institucionit që i realizon, ndërsa 10 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Ky rregullim synon të krijojë mundësi më të mira për riinvestimin e të ardhurave në veprimtarinë artistike dhe kulturore, financimin e prodhimeve dhe projekteve të reja, zhvillimin e repertorit vjetor, përmirësimin e shërbimeve, zhvillimin profesional të personelit dhe pasurimin e koleksioneve të artit. Njëkohësisht, përcaktimi i rregullave për administrimin, raportimin dhe monitorimin financiar synon të garantojë përdorimin e ligjshëm, ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë kuadër, është evidentuar gjithashtu nevoja për të përcaktuar parime të qarta për tarifat e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, duke garantuar proporcionalitetin, transparencën dhe trajtimin e barabartë, si dhe mundësinë e aplikimit të tarifave të reduktuara ose përjashtimeve nga pagesa për kategori të caktuara të publikut. Për këtë qëllim, projektligji parashikon përcaktimin e masës së tarifave dhe rregullave përkatëse nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave.

Për rrjedhojë, ndërhyrja legjislative synon krijimin e një kuadri më të qartë, të harmonizuar dhe funksional, i cili t'u përgjigjet nevojave aktuale të sektorit, të forcojë kapacitetet dhe qëndrueshmërinë e institucioneve publike, të nxisë zhvillimin e krijimtarisë artistike dhe kulturore dhe të garantojë një administrim më transparent dhe të përgjegjshëm të burimeve publike, duke rritur njëkohësisht aksesin dhe pjesëmarrjen e publikut në jetën artistike dhe kulturore.

Propozimet

Projektligji propozon ndryshimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues nëpërmjet riformulimit të objektit dhe fushës së zbatimit të ligjit, si dhe përditësimit të përkufizimeve të koncepteve themelore në fushën e artit dhe kulturës. Në këtë drejtim, përcaktohen më qartë konceptet e artit, artistit, profesionistit të kulturës, cilësisë artistike, projektit artistik, prodhimit artistik, veprës së artit dhe skenës së pavarur kulturore, duke reflektuar diversitetin e formave të krijimtarisë dhe të veprimtarisë artistike e kulturore bashkëkohore.

Gjithashtu, propozohet shtimi i një dispozite të posaçme për përcaktimin e fushave të veprimtarisë artistike dhe kulturore, duke përfshirë artet pamore dhe të aplikuara, fotografinë, dizajnin, artet skenike dhe performuese, muzikën, kinematografinë, krijimtarinë audiovizuale dhe digjitale, letërsinë, botimet, veprimtaritë bibliotekare dhe arkivore, veprimtaritë muzeore që lidhen me koleksionet e artit, si dhe veprimtaritë kërkimore, kuratoriale, edukative dhe multidisiplinare. Këto veprimtari parashikohet të ushtrohen në përputhje me legjislacionin sektorial përkatës.

Në kuadër të zgjerimit të fushës institucionale të ligjit, propozohet plotësimi i listës së institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, si dhe përfshirja e institucioneve të tjera publike qendrore që ushtrojnë funksione në këtë fushë. Për këto institucione parashikohet zbatimi i dispozitave të ligjit për aq sa nuk bien në kundërshtim me legjislacionin e posaçëm që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre.

Projektligji propozon gjithashtu riformulimin e qëllimit dhe funksioneve të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke përfshirë krijimin, prodhimin, interpretimin, koleksionimin, dokumentimin, arkivimin, restaurimin, digjitalizimin, promovimin dhe shpërndarjen e veprave artistike e kulturore. Në këtë kuadër, përcaktohen edhe parimet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e tyre, si autonomia profesionale dhe artistike, liria e shprehjes dhe krijimtarisë, pluralizmi artistik, aksesi publik, transparenca, profesionalizmi dhe diversiteti kulturor.

Në drejtim të organizimit dhe drejtimit institucional, propozohen ndryshime që synojnë qartësimin e rolit të organeve drejtuese dhe kolegjiale, përcaktimin e procedurave për miratimin e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të brendshëm, si dhe përmirësimin e rregullave për përbërjen, emërimin dhe mandatin e anëtarëve të bordeve artistike. Në veçanti, parashikohet që anëtarët e bordeve artistike të emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, mbi bazën e propozimeve të titullarit të institucionit përkatës, me mandat katërvjeçar dhe të drejtë riemërimi.

Në aspektin financiar, projektligji propozon riformulimin dhe zgjerimin e burimeve të financimit të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke përfshirë financimin nga Buxheti i Shtetit, të ardhurat nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, shitja e biletave, shitja dhe shfrytëzimi ekonomik i veprave artistike e kulturore, ofrimi i shërbimeve profesionale, bibliotekare, dokumentare dhe digjitale, financimet nga projektet dhe programet e ndryshme, si dhe sponsorizimet, donacionet dhe burime të tjera të ligjshme.

Një nga risitë kryesore të projektligjit është përcaktimi i mekanizmit të administrimit dhe përdorimit të të ardhurave të realizuara nga institucionet, sipas të cilit 90 për qind e të ardhurave nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, shitja e biletave dhe shërbimet e përcaktuara në ligj përdoren në favor të institucionit që i realizon, nëpërmjet buxhetit të miratuar të tij, ndërsa 10 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit. Gjithashtu, përcaktohen destinacionet e përdorimit të këtyre të ardhurave, përgjegjësitë për administrimin e tyre, mekanizmat e raportimit dhe monitorimit financiar, si dhe parimet për përcaktimin e tarifave të shërbimeve. Për këtë qëllim, parashikohet miratimi me vendim të Këshillit të Ministrave i masës së tarifave, kategorive përfituese të reduktimit ose përjashtimit nga pagesa dhe procedurave përkatëse.

Në funksion të garantimit të aksesit të publikut në art dhe kulturë, projektligji parashikon mundësinë e aplikimit të tarifave të reduktuara ose përjashtimeve nga pagesa për kategori të caktuara, si fëmijët, nxënësit, studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre, studiuesit dhe grupet pjesëmarrëse në veprimtari edukative.

Gjithashtu, propozohet ndryshimi i dispozitës që lidhet me burimet e financimit të institucioneve publike vendore të artit dhe kulturës, nëpërmjet heqjes së referimit ndaj Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës, si dhe parashikimi i dispozitave zbatuese dhe kalimtare, që përcaktojnë afatet për miratimin e akteve nënligjore dhe harmonizimin e statuteve dhe rregulloreve të institucioneve me ndryshimet e propozuara.

Në tërësi, propozimet synojnë krijimin e një kuadri ligjor më të qartë dhe funksional, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe financiare, përmirësimin e administrimit të burimeve, si dhe krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e krijimtarisë artistike, ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore dhe rritjen e aksesit e pjesëmarrjes së publikut në jetën artistike dhe kulturore.

Pyetjet

Në vijim të procesit të konsultimit publik, palët e interesuara ftohen të paraqesin vlerësimet, komentet dhe propozimet e tyre lidhur me përmbajtjen e projektligjit, duke iu referuar, ndër të tjera, çështjeve të mëposhtme:

1. A i konsideroni të qarta dhe të përshtatshme përkufizimet dhe fushat e veprimtarisë artistike dhe kulturore të parashikuara në projektligj? A vlerësoni se nevojitet përfshirja e kategorive apo formave të tjera të veprimtarisë?
2. Si i vlerësoni përcaktimet për njohjen dhe përfshirjen e artistëve dhe profesionistëve të kulturës, si dhe të skenës së pavarur kulturore?
3. A vlerësoni se ndryshimet e propozuara krijojnë kushte më të përshtatshme për organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke garantuar autonominë profesionale dhe artistike?
4. Si e vlerësoni mekanizmin e propozuar për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, përfshirë ndarjen 90 për qind në favor të institucionit dhe 10 për qind në Buxhetin e Shtetit?
5. A i konsideroni të përshtatshme parashikimet për përcaktimin e tarifave të shërbimeve dhe aplikimin e tarifave të reduktuara ose përjashtimeve për kategori të caktuara të publikut?
6. Çfarë propozimesh konkrete keni për përmirësimin e mëtejshëm të projektligjit, me qëllim zhvillimin e artit dhe kulturës, forcimin e institucioneve dhe zgjerimin e aksesit të publikut në jetën kulturore?

Palët e interesuara janë të mirëpritura të paraqesin edhe komente apo propozime të tjera që i vlerësojnë të rëndësishme për përmirësimin e projektligjit.